UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/269
Datë: 25/7/2019

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me kërkesë të disa njësive akademike të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me datë 19.07.2019, mori:

VENDIM

Për regjistrim të kandidatëve në programe studimore të cilat nuk janë plotësuar në afatin e parë të konkursit nr. 1/909, dt. 09.07.2019, për pranimin e studentëve në vitin akademik 2019/20, respektivisht në programet të cilat kanë pasur teste të njëjta të provimit pranues dhe për të cilat kandidatët kanë kaluar pragun e kalueshmërisë

1. Aprovohet kërkesa e disa prej njësive akademike të Universitetit të Prishtinës, për lejimin e regjistrimit të kandidatëve në programe të njëjta studimore (me korrespondencë) apo programe tjera studimore brenda njësisë akademike në të cilat nuk janë plotësuar vendet e parapara me konkurs për vitin akademik 2019/20 dhe të cilat kanë pasur teste të njëjta të provimit pranues, me kusht që kandidatët të kenë kaluar pragun e kalueshmërisë në programe studimore në të cilat fillimisht kanë aplikuar.

2. Pranimi i kandidatëve do të bëhet vetëm në ato programe studimore në të cilat kanë mbetur vende të lira nga afati i parë i konkursit, dhe për të cilat kandidati shpreh interesim për pranim, gjithnjë duke respektuar listën prioritare të kandidatëve të pa pranuar për shkak të plotësimit të vendeve të parapara me konkurs në programet në të cilat fillimisht kanë aplikuar.

3. Ky vendim hyn në fuqi nga data e miratimit dhe do të implementohet nga njësitë akademike përkatëse dhe Shërbimi i studentëve në Administratën qendrore të Universitetit të Prishtinës.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Menaxhmentit të UP-së;
3. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
4. Dekanëve të njësive akademike të UP-së,
5. Sekretarëve të njësive akademike;
6. Drejtorit të TI-së;
7. Zyrës ligjore të UP-së;
8. Drejtorit të zyrës për çështje të studentëve;

Prof. Dr. Marjan Dema

Kryesues i Senatit të UP-së

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" UNIVERSITY OF PRISHTINA 1970